



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 247/1 Prot.

Pogradec, më 21 . 01 . 2021

VENDIM

Nr. 02 , Datë 20 . 01 . 2021

**PER MIRATIMIN E KRITEREVE TË FAMILJEVE NË NEVOJË QË DO TË
TRAJTOHEN ME FONDIN DERI NË 6% NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-
NDIHMËN EKONOMIKE PËR VITIN 2021.**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1, 1, shkronja (a) dhe (b), nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; nenit 21 të ligjit nr.57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", vendimit nr.597, datë 4.09.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", udhëzimit nr.5, datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% (i ndryshuar) me propozim të Kryetarit Bashkisë Pogradec, Këshilli:

VENDOSI

1. Të miratojë kriteret mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% ose me fondet e buxhetit vendor, për vitin 2021.

Familjet aplikuese për ndihmë ekonomike të cilat janë refuzuar nga sistemi elektronik I Ndihmës ekonomike pasi kanë marrë pikë të pamjaftueshme dhe plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a. Të përfitojnë familjet me shumë fëmijë , me nevoja sociale të theksuara , të cilat nuk kanë dalë fituese nga sistemi.
- b. Gratë e veja me fëmijë .
- c. Gratë e divorcuara me fëmijë.
- d. Beqarët të ngelur vetëm , në moshë mbi 40 vjet , të pamundur për të punuar.
- e. Familje që kanë në përbërje të tyre persona me aftësi të kufizuar.

2. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KESHILLIT
Sotiraq MANGËRI

